

**VENDIM**  
**Nr.323, datë 24.7.1992**

**PËR ÇMIMET E PLEHRAVE KIMIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Çmimet e plehrave kimike të prodhuara në vend ose të importit liberalizhen dhe caktohen sipas kërkesës e ofertës në marrëveshje ndërmjet palëve.

2. Diferencat ndërmjet çmimeve të reja (të liberalizuara) dhe çmimeve të mëparshme të derdhen në buxhetin e shtetit, për sasitë që do të jenë gjendje në ndërmarrjet shtetërore dhe njësitë përkatëse, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.308, datë 20.7.1992 "Për liberalizimin e çmimeve dhe tarifave dhe kompetencat e caktimit të tyre", në pasqyrën nr.2, pika 9 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**